



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 13/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesuese, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me zyrtaren e lartë ligjore, Antigona Murati duke vendosur përkritazi me ankesën e Fatmir Smajlit, nga subjekti politik Fjala, paraqitur kundër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos përfshirjes në Ftesë për propozim të anëtarëve të KVV, për Zgjedhjet e Parakohshme të Kuvendit të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 26.05.2017, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**HEDHET** si e palejueshme ankesa e Fatmir Smajlit, nga subjekti politik Fjala,

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 25.05.2017, nga Fatmir Smajli, Anëtar i Kryesisë Qëndrore, nga subjekti politik " FJALA", i cili pretendon se më datë 24.05.2017, KQZ ju ka dërguar ftesë për propozimin e personave për anëtarët e KVV-së për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare. Në dokumentin të cilin e ka lëshuar KQZ-ja në bazë të formulës sipas parashtruesit të ankesës nuk është përfshirë partia FJALA dhe nuk ju ka dhënë e drejta që të nominojë KVV nga subjekti në fjalë.

Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelja e nenit 4 të Rregullës Zgjedhore 19/2016 për këshillat e VV dhe kërkon që kjo shkelje të evitohet dhe në formulën e shpërndarjes të parashihen edhe komisionar të subjektit politik FJALA.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në më datën 25.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit deri më datën 26.05.2017.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ brenda afatit të caktuar me të cilën theksohet se KQZ me datën 24.05.2017, përmes KKZ-ve ju ka dërguar ftesë subjekteve politike për propozimin e personave për anëtar të KVV-ve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017. KQZ konsideron se ankesa e subjektit politik Fjala, është e pabazuar sepse në bazë të nenit 77.4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e

KVV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni. Gjithashtu bazuar në nenin 4 paragrafi 3 të Rregullës Nr. 19/2016 për Këshillat e Vendvotimeve, në rast kur ka numër të vogël të subjekteve politike të certifikuara, KQZ me vendim mund të miratoj formulë tjetër nga paragrafi 1 dhe 2 i nenit të 4 të Rregullës së lartcekur, e cila garanton integritet të procesit zgjedhor, duke u bazuar në rezultatet e zgjedhjeve paraprake.

PZAP-i, pasi e shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se ankesa është e palejuar sepse KQZ-ja në kohën e caktuar i fton të gjitha subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në kuvendin komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore që ti dorëzojnë propozimet e tyre në KKZ për personat që dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunave të tyre duke zbatuar rregullat zgjedhore. KQZ deri me tani ende nuk ka marrë vendim lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017.

Andaj, paneli vlerëson se ankesa e ankuesit është e palejuar për faktin se, KQZ-ja, nuk ka marrë vendim lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV) për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 13/2017 më datën 26.05.2017

**Kryesuesi i Panelit  
Gyltene Sylejmani**



### ***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*